



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 64.
Prishtinë, më 26.03.2013 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Mufera Sinik Rasim Demiri dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Elmi Reçica, Glauk Konjufca dhe Petar Miletic.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuese e OSB-së, Lejla Selimi, përfaqësuese e Ambasadës Zvicerane Sakibe Jashari, përfaqësues i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti, gazetarë e Kohës Ditore - Blerta Aliu, gazetarë Kosovapres - Teuta Gashi, përfaqësues i zyrës së Presidencës (ZPRK) Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tisma, zyrtarë e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu, praktikanti nga UNDP -ja Eldin Buzgovic

Mbledhjen e kryesoi: **Goran Marinkovic**, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.02.2013 dhe 11.03.2013;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit për provimin e jurisprudencës me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion.**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L- 184 për administrimin e punës në zyrë;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**
6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-176 për turizmin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Indutri;**

7. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr.04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
8. **Të ndryshme.**

Kryesuesi – konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të kaluara.

Kryesuesi - konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjeve të mbajtura më 26.02.2013 dhe 11.03.2013, pa vërejtje.

Kryesuesi – njoftoi komisionin se në bazë të marrëveshjes për ndarjen e mandateve ndërmjet përfaqësuesve të komuniteteve në Komision, janë krijuar kushtet për zëvendësimin e mandatit të anëtarit Xhevdet Neziraj me anëtarin Mursel Halili.

Në emër të komisionit i shpreh mirëseardhje zot. Mursel Halili, i cili do të përfaqëson komunitetin goran dhe se do të kemi bashkëpunim të mirë.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për provimin e jurisprudencës me amendamentet e Komisionit funksional për Legislacion;

Kryesuesi – paraqet për shqyrtim Projektligjin për provimin e jurisprudencës dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandim i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Me që nuk kishte vërejte, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin provimin e jurisprudencës dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L- 184 për administrimin e punës në zyrë;

Kryesuesi- paraqet për shqyrtim Projektligjin nr. 04/L- 184 për administrimin e punës në zyrë dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandim i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Në fjalinë e tij tha se gjatë punës shpesh herë hasim në parregullsi, sa i përket përkthimit të dokumenteve në gjuhën serbe. Ai tha se Grupi Parlamentar i SLS ka paraqit vërejtje në Komisionin Funksional që të bëhet standardizimi dhe harmonizimi gjuhësor i tekstit të Projektligjit.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L- 184 për administrimin e punës në zyrë dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Me që nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- III. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- IV. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-176 për turizmin me amandamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Indsutri;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr.04/L-176 për turizmin dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr.04/L-176 për turizmin dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr.04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- III. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr.04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- IV. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

8. Të ndryshme.

Kryesuesi – e njoftoi Komisionin se në bazë të Planit të Veprimit për mbikëqyrjen e strategjisë për integrimin e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë është formohet grupi punues në këtë përbërje:

- Albert Kinolli, Lumnije Morina, Rasim Demiri, Jelena Bontic dhe Xhevdet Neziraj.

Në kuadër të monitorimit të Ligjit për përdorimin e gjuhës është formuar grupi punues me këtë përbërje:

- Goran Marinkovic, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Jelena Bontic dhe Mufera Sinik

Njëkohësisht, Komisioni ka emëruar grupin e dytë punues për monitorimin e Ligjit për Hoqën e Madhe dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit me këtë përbërje:

- Jasmina Zivkovic, Petar Miletic, Lirije Kajtazi, Mufera Sinik, Rasim Demiri.

Komisioni mur qëndrim që për konsolidimin e grupeve punuese do të mbahet mbledhja e rregullt me datën 2.04.2013 në ora 10:00, ku do të fillohet me punë e mbikëqyrjes së implementimit të ligjeve të lartcekura dhe njëherit do të caktohen kryetarët e secilit grup punues.

Mursel Halili – ndjehet i privilegjuar që ka mandat në këtë komision dhe njëherit përshëndeti anëtarët e komisionit, administratën për mbështetje të komisionit dhe përfaqësuesit të tjerë.

Foli lidhur me marrëveshjen për caktimin e mandatit të përfaqësuesve të komunitetit goran, ashkali dhe egjiptian. Në këtë periudhë, komuniteti goran nuk kishte mandat të përhershëm e që ka qen shumë e nevojshme kur bëhet fjalë për shqyrtimin e ligjeve

Ai theksoi se neni 78 i Kushtetutës, e cila rregullon pyetjen e anëtarësimit në Komision është në kundërshtim me nenin 66 të Kushtetutës e cila ka të bëjë me strukturën e Kuvendit. Ishte i mendimit se lidhur me këto çështje komisioni duhet të jetë më ekspeditiv. Njëherit shprehu qëndrimin e tij se në mbledhjet e ardhshme do të nxis çështjen e ndryshimit të Kushtetutës.

U ndërlidh se komuniteti jonë ka vërejte në Ligjin për parkun Nacional ‘Sharr’ dhe kërkoi nga komisioni që të marr iniciativë dhe të ftohet ministri z. Dardan Gashi.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic